

## Funksionet dhe detyrat e A.P

Funksioni kryesor i Gjykatës është dhënia e drejtësisë, nëpërmjet vendimeve gjyqësore në përfundim të procesit gjyqësor.

Pushteti gjyqësor ushtrohet nga Gjykata e Lartë, si dhe nga Gjykatat e Apelit dhe Gjykatat e shkallëve të para, të cilat krijohen me ligj.

Pushteti gjyqësor ushtrohet Në emër të Republikës, në përputhje me Kushtetutën, dhe me legjislacionin tjetër në fuqi.

Gjyqtarët, gjatë ushtrimit të funksionit dhe vendimmarrjes, janë të pavarur dhe të paanshëm.

Në ushtrimin e pushtetit gjyqësor çdo gjykatë ndihmohet nga administrata gjyqësore, e cila përfshin shërbimet e nëpunësve civilë gjyqësorë dhe shërbime të tjera mbështetëse. Në ushtrimin e veprimtarisë së saj, administrata gjyqësore respekton pavarësinë e gjyqtarëve, duke shmangur çdo ndërhyrje në veprimtarinë e sistemit gjyqësor.

Çdo ndërhyrje në veprimtarinë e sistemit gjyqësor sjell përgjegjësi sipas ligjit.

Sipas Neni 5 i Vendimit **Nr. 150, datë 29.03.2023 të KLGJ “Organet vendimmarrëse”**

1. Organet vendimmarrëse të Gjykatës janë:

- a) Kryetari;
- b) Këshilli i Gjykatës;
- c) Mbledhja e Përgjithshme e Gjyqtarëve;
- ç) Kancelari.

2. Kryetari është përgjegjës për drejtimin dhe administrimin e përgjithshëm gjyqësor të gjykatës, sipas ligjit dhe kësaj rregullore.

3. Këshilli i Gjykatës përbëhet nga kryetari, zëvendëskryetari dhe kancelari. Ai është përgjegjës për mirëfunksionimin e shërbimeve administrative të gjykatës, sipas ligjit dhe akteve nënligjore të miratuara nga Këshilli i Lartë Gjyqësor për këtë qëllim.

4. Zëvendëskryetari ushtron kompetencat e kryetarit në mungesë të tij.

5. Mbledhja e Përgjithshme e Gjyqtarëve përbëhet nga të gjithë gjyqtarët e gjykatës dhe ushtron kompetencat sipas ligjit.

6. Kancelari është nëpunësi civil gjyqësor më i lartë dhe përgjegjës për menaxhimin e administrimit gjyqësor, sipas ligjit dhe kësaj rregulloreje.